

Dje komunën tonë e ka vizituar Vesna Civriq, kryetarja NV "Duga" nga Ada. Qëllimi i vizitës është projekti për themelimin e Zyrës për zvoglimin e varfëris, e cila realizohet në bashkëpunim me Ministrin për punë dhe politikën sociale të Republikës të Sërbis.

"Me hapjen e kësaj zyre, konsiderojmë këthimin e dinjitetit të njeriut, personat të cilët i turpërohen varfëris, të cilët nuk dojnë të kërkojnë lëshime, por dëshirojnë të punojnë diçka, ajo ju mundësohet përmes kësaj zyre", ka thënë Vesna.

Kryetari i komunës, Dr Nebojsa Arsiq ka thënë "Që përmesë kësaj rruge do të bëhet hapi i rëndësishëm në luftën kundër varfëris dhe që në atë mënyrë do tju ndihmohet personave të rrezikuar socialisht që më lehtë të vinë deri te fitimi për ushqim, shërbime dhe barnave, si dhe të marrin këshilla të caktuara".

Hapja e zyrës pritet të bëhet për një muaj ditë, pas rregullimit të nevojshëm të dokumentacionit.